



STATUT

I SHOQËRISE TREGTARE “LAÇAJ 2007” SHPK

Me qëllim implement dhe funksionimin e shoqërisë me ligjin e ri në bazë të nenit 230 të ligjit 9901 dt.14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” dhe ligjit 9723 dt. 03.05.2007 “për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit” Ortaku i vetëm i shoqërisë harton këtë statut.

KREU I

Emri i Shoqërisë , Selia, Kohëzgjatja, Objekti

Formimi i Shoqërisë

Neni 1

- Është formuar shoqëria “LAÇAJ 2007” Sh.P.K që me poshtë do të quhet “Shoqëria” me ortakë:

Z.GANI LAÇAJ, i biri i FAIK-ut , shtetas shqiptar lindur më 13-02-1951 lindur në Durrës e banues në Berat, mbajtës i letër njoftimit elektronik nr.025210532, madhor e me zotësi të plotë për të vepruar;

NENI 2

Emri i shoqërisë tregtare, forma ligjore e shoqërisë, numri unik i identifikimit, vendndodhja e shoqërisë, emri i administratorit, duhet të jenë të përmendura në të gjitha aktet e nxjerra nga kjo shoqëri, nëpërmjet përdorimit të letrës apo mjeteve elektronike, dhe që ju

drejtohen të tretëve. Shoqëria ka vulën e saj me madhësi të zakonshme dhe me përmbajtjen përreth saj.

Selia e Shoqërisë

Neni 3

3. 1 Selia zyrtare e Shoqërisë ndodhet në adresën :LAGJJA 30 VJETORI BERAT. Në Republikën e Shqipërisë.

3. 2 Gjatë ushtrimit të aktivitetit të saj Shoqëria mund të hapë degë dhe zyra përfaqësimi kudo në teritorin e Republikës së Shqipërisë.

3. 3 Kjo shoqëri mund të ndyshojë emrin e saj , vendqëndrimin dhe objektin e aktivitetit të saj sipas vendimeve të asamblesë së ortakëve.

Kohëzgjatja e veprimtarisë ekonomike

Neni 4

4. 1 Kohëzgjatja e veprimtarisë së Shoqërisë është e pakufizuar.

Objekti i veprimtarisë së Shoqërisë

Neni 5

Shoqëria Tregtare “ **LAÇAJ 2007**” sh.p.k do të ketë për objekt të veprimtarisë së saj si më poshtë;

Ne fushen e ndertimit dhe investimeve per ndertim,punime dheu, sistemime,tarracime,ndertime civile,ekonomike,bujqesore,kulturore, sportive,ndertime banesash,hotele fshatra turistike,asfaltime ndertim



rrugesh,autostrada,ura porte,aeroporte,kanalizime,tregti materiale ndertimi,import eksport te artikujve te ndryshem industrial,lende drusore,paisje hidrosanitare,projektim e ndertim konstruksione metalike.

Neni 6.

Ortaku i vetëm i shoqërisë ka të drejtë të zgjerojë aktivitetin e tij në të ardhmen duke lidhur kontrata apo akt-marrëveshje me persona fizikë ose juridikë, vendas apo të huaj. Mbi këtë bazë do të zgjerohet edhe fusha e veprimtarisë së shoqërisë.

Neni 7

Do të konsiderohen veprimtari e shoqërisë vetëm ato veprime juridiko-civile që do të kryhen nga organet ose punonjësit e saj konform disponimeve të këtij statuti dhe kurdoherë në mbështetje të legjislacionit në fuqi.

Kapitali themelor i shoqërisë.

Neni 8.

Kapitali themelor I shoqërisë është 100.000,00 leke , formuar dhe nenshkruar nga ortaku I vetem, I ndare ne 100,00 kuota, me vlere nominale 1 kuote / 1000,00 leke.

Ortaku i vetëm ka pavarësi ligjore, organizative si dhe te drejta pronësie mbi çdo lloj kapitali, mjete xhiroje si dhe mbi çdo lloj pasurie tjetër të fituar në rrugë të ligjshme. Shoqëria përgjigjet vetem me kapitalin e saj.

Neni 9.

Shoqëria çel llogari bankare në lekë vendi dhe çdo lloj valute, në Banka vendase ose të huaja, private apo shtetore, me qëllim për të kryer veprimet e nevojshme për ushtrimin dhe përballimin financiar të aktivitetit të saj.

Ortaku i vetëm dhe administratori i caktuar prej tij, depozitojnë faksimilet e firmave të tyre origjinale në Bankat ku është çelur llogaria dhe tërheqja e pjesëve të saj bëhet kur çeku banker është firmosur nga ortaku i vetem dhe Administratori i shoqërisë, në rastin kur ortaku i vetëm cakton një administrator dhe vetëm me firmën e ortakut të vetëm, kur ky vetë kryen njëkohësisht dhe detyrën e Administratorit të Përgjithshëm të shoqërisë.

NENI 10

Pjesët e kapitalit themelor, janë lirisht të transferueshme në rrugë trashëgimie sipas dispozitave të Kodit Civil Tjetërsimi i pasurisë bëhet sipas kriterëve të percaktuara në ligje.

Ortaku i vetem , ka te drejtë të transferojë jashtë teritorit te Republikës së Shqipërisë pjesërisht apo tërësisht kontributet e saj përfshirë dhe fondet dhe kontributet e pjesëve te kapitalit themelor, duhet të jenë te vertetuara me Akt Noterial dhe për një gjë të tillë ortaku i vetem duhet te marre paraprakisht vendim me shkrim. Shoqeria dhe të tretët duhet të respektojnë keto transferime sapo tu behen te ditura.

NENI 11

Gjithë fitimi i kësaj shoqërie i përket ortakut te vetëm të saj **Z.GANI LAÇAJ** i cili është edhe pronarë i saj. Ky fitim do të disponohet lirisht pasi të jenë shlyer më parë detyrimet fiskale dhe ato ndaj të tretëve.

Organet drejtuese të shoqërisë.

NENI 12.

Organ drejtues dhe vendimor në këtë shoqëri është ortaku i vetëm i saj **Z.GANI LAÇAJ** i cili është dhe administrator i kësaj shoqërie për një afat kohor 5 vjeçar me të drejtë rizgjedhje i cili e përfaqëson atë juridikisht në të gjitha organet apo në organizmat e aparatit shtetëror si dhe në marrëdhëniet me të tretët, kur veprimet kanë të bëjnë me disponimin e interesave material të shoqërisë.

Ortaku i vetem i shoqërisë është njëkohësisht dhe administrator i saj. Me autorizimin me shkrim të nënshkruar nga ortaku i vetëm, shoqërinë mund ta përfaqësoje çdo person tjetër.



NENI 13.

Ortaku i vetëm i shoqërisë ka keto të drejta dhe detyrime kryesore:

- . organizon punën dhe përfaqëson shoqërinë**
- .lidh dhe nënshkruan kontrata si dhe akte të tjera**
- . bën caktimin e punëtorëve në vendin e punës**
- . jep masat disiplinore**
- . bën zgjidhjen e konflikteve në mes punëtorëve**
- . kujdeset për zbatimin e dispozitave ligjore, dispozitave të këtij statuti dhe akteve ligjore e nënligjore që kanë lidhje me veprimtarinë private.**

Administrimi, viti financiar, bilanci

NENI 14.

Mjetet e investuara për themelimin e shoqërisë si dhe ato të shtuara nga aktiviteti i saj i zgjeruar regjistrohen në librin afarist të shoqërisë menjëherë. Shoqëria është pronare, përdoruese, disponuese e pasurive në emer të vet në përputhje me qëllimin dhe objektin e veprimtarisë së saj. -20% E fitimit të viteve ushtrimore do të përdoret për të mbuluar provigjonet për të gjitha periodat.



NENI 15.

Viti financiar fillon më 1 janar dhe mbaron më 31 dhjetor të çdo viti. Llogaritë vjetore, inventari, raportet mbi operacionet e vitit financiar dhe çdo raport tjetër i veçantë në këtë drejtim, pas shqyrtimit i paraqiten për miratim pronarit të shoqërisë Brenda tre muajve dhe në çdo rast, jo më vonë se tre muaj nga data e mbylljes së vitit.

NENI 16.

Pasuritë e shoqërisë vlerësohen me bilancet e saj, me vlera të shprehura në monedhë shqiptare dhe të huaj, në përputhje me dispozitat ligjore përkatëse të zbatuara në Shqipëri. Shkëmbimi i monedhës shqiptare me të huaj dhe e kundërta bëhet në përputhje me kursin e caktuar nga Banka në momentin e këmbimit të saj.

Punësimi në shoqëri.

NENI 17.

Marrëdhëniet e punës në shoqëri rregullohen nëpërmjet kontratës së punës, e cila mund të jetë kolektive dhe individuale. Çështjet të cilat nuk gjejnë rregullim në kontratat e punës zgjidhen sipas legjislacionit shqiptar: Kodi I Punës dhe çdo akt tjetër ligjor e nenligjor që ka të bëjë me këtë çështje.

I punësuarit nuk merr pjesë në ndarjen e fitimit të cilin e realizon shoqëria gjatë veprimtarisë së saj apo edhe në humbjet e saj, nëse në kontratën e punës nuk është përcaktuar ndryshe. Ai përgjigjet materialisht për dëmet që i shkakton shoqërisë me faj.

Shpërbërja dhe likuidimi I shoqërisë

NENI 18.

Shoqëria mund të shpërbëhet në rastet:

- . me vendim të ortakut të vetëm të saj kur për dy vjet radhazi shoqëria nuk rezulton rentable
- . Me plotësimin e afatit të kohëzgjatjes së aktivitetit të shoqërisë
- . Në rast falimentimi ekonomik
- . Në ato raste kur shprehimisht do të citohet një gjë e tillë nga legjislacioni në fuqi.

NENI 19.

Shoqëria hyn në procesin e likuidimit të saj qysh në momentin e prishjes ose të shpërberjes. Pas shlyerjes së detyrimeve tatuese fiskale dhe atyre ndaj të tretëve përcaktohen pasuritë e ngelura, të cilat i kthehen tërësisht ortakut të vetëm të shoqërisë që është dhe pronar i saj.

NENI 20.

Mosmarrëveshjet juridiko-civile të lindura midis personave pjesëmarrës ose jo në shoqëri, kur nuk mund të zgjidhen në mirëkuptim me njëri tjetrin, do të zgjidhen nga Gjykata e Rrethit Tiranë ose çdo Gjykatë tjetër kompetente sipas legjislacionit shqiptar.

NENI 21.

Ky statut përpilohet ne 4 kopje të barabarta në gjuhën shqipe dhe hyn në fuqi ditën e regjistrimit të shoqërisë pranë QKR Berat, një kopje e këtij statuti do të ruhet në dokumentacionin bazë të

Shoqërisë Tregtare "LAÇAJ 2007" SH.P.K

ORTAKU I VETEM I SHOQERISE

(GANI LAÇAJ)



Berat 03/05/2012